



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 52 prot.

Kamëz, më 25.5.2026

V E N D I M
Nr. 45 Datë 25/5 2026
MBI

“MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR ATO FAMILJE NË NEVOJË QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË PËR VITIN 2026”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.05.2026, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.33 Datë 19.05.2026 në mbështetje të Kushtetutës, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social” i ndryshuar, Ligji për Kodin Administrativ në Republikën e Shqipërisë, Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.362 date 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies subvencionimit qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; Vendimit nr.133 datë 24.10.2022, të Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit”; Vendimit nr.80 datë 20.11.2025 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e manualit të subvencionimit të qirasë në Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë”; VKB nr 90 dt.17.12.2025 për “Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2026, 2027, 2028”; Relacionit të Komisionit të Strehimit me Prot 5376 date 18.05.2026 **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e trajtimit me subvencion të qirasë për 33 familje, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi me vlerë *totale shtatë mujore 4,684,068 (katër milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtë e tetë) Lekë.*
2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë 7 (shtatë) mujore duke filluar nga data 01.06.2026 deri në datën 31.12.2026.
3. Përfundimin e trajtimit me bonusin e qirasë për 1 familje, sipas relacionit pjesë përbërës i këtij Vendimi.
4. Efektet financiare që rrjedhin nga pika 1 *do të përballohen në raportin 100% nga buxheti i Bashkisë Kamëz.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

5. Të ngarkojë Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

